



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONETE PËR KOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrat

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

Të dhënat e fëmijës aplikues dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave

**NUMËR: 48 /2007**

**DATË: 9.10. 2007**

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr.1/2007, neni 32, 35 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT), nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

### Neni 1

#### Qëllimi

Ky UA ka për qëllim të përcaktojë të dhënat e nevojshme për fëmijën aplikues dhe mënyrën e mbledhjes së të dhënave.

### Neni 2

#### Kërkesa

Çdo prind ose kujdestar ligjor i fëmijës (në tekstin e mëtejme prind) për ta regjistruar fëmijën në institucionin parashkollor duhet ta plotësojë kërkesën, e cila mirret në institucionin parashkollor ku do ta regjistrojë fëmijën.

### Neni 3

#### Përmbajtja e kërkesës

Kërkesa duhet të përmbajë këto të dhëna për fëmijën:

- a) emri i fëmijës, emri i prindit dhe mbiemri,

- b) data dhe vendi i lindjes,
- c) vendbanimi, adresa,
- d) data e dorëzimit të kërkesës, dhe
- e) nënshkrimi i prindit.

#### **Neni 4**

##### **Të dhënat personale për fëmijën**

Të dhënat personale për fëmijën janë:

- a) dëshmia nga mjeku për gjendjen shëndetësore të fëmijës,
- b) dëshmia për vaksinimin e fëmijës,
- c) pesha dhe gjatësia e fëmijës në fillim të vitit.

#### **Neni 5**

##### **Të dhënat për prindërit**

Kërkesa duhet të përmbajë këto të dhëna për të dy prindërit:

- a) emri dhe mbiemri,
- b) vendi i punës, kualifikimi dhe nr. i telefonit, email adresa,
- c) numri i anëtarëve të familjes së ngushtë, dhe
- d) numri i fëmijëve tjerë të vendosur në IP.

#### **Neni 6**

##### **Dosja**

IP duhet të formojë dosje për secilin fëmijë me të gjitha shënimet e kërkuara dhe ta përcjellë e plotësoj për çdo vit deri në mbarim të edukimit parashkollor.

#### **Neni 7**

##### **Ruajtja e dosjes**

Pas mbarimit të arsimit dhe edukimit parashkollor, një kopje e dosjes i jepet fëmijës dhe një kopje ruhet sipas ligjit mbi arkivimin.

#### **Neni 8**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.

---

**Agim Veliu, ministër**